

Landratsamt Freising  
Gesundheitsamt  
Johannisstr.8  
85354 Freising  
Tel.08161/600-84-344  
Fax 08161/600-84-399

## Ftesë për ekzaminimin e përmirësuar të pranimit në shkollë

Të dashur prindër,



Sot po ju ftojme juve dhe fëmijën tuaj në ekzaminimin e pranimit në shkollë. Në Bavari, më parë ky ekzaminim zhvillohej për të gjithë fëmijët një vit përpara fillimit të shkollës.

Megjithatë, rezultatet e projektit pilot “Shqyrtimi i shëndetit dhe zhvillimit në moshën e kopshtit” (GESiK), i cili u realizua në gjashtë rajone pilot, konfirmojnë se ekzaminimi i hershëm ka përparësi për fëmijët.

Nëse vonesat në zhvillim dhe dëmtimet shëndetësore zbulohen në moshat 4 deri në 5 vjeç, fëmijët kanë më shumë kohë për mbështetje ose terapi në mënyrë që të jenë në një hap me bashkëmoshatarët e tyre. Kjo e bën më të lehtë për fëmijët dhe familjet e tyre fillimin e eksperiencës së shkollës.

Bazuar në rezultatet nga projekti pilot, ekzaminimi i mëparshëm i pranimit në shkollë është rishikuar. Kjo rezultoi me përmirësimin e ekzaminimit të pranimit në shkollë (rSEU), i cili parashikon zhvillimin e ekzaminimit të fëmijëve që janë në vitin e parafundit të kopshtit. Prandaj, zbatimi i ekzaminimit të pranimit në shkollë do të kryhet një vit më herët. Megjithatë, fëmija juaj **nuk** do të fillojë shkollën më herët!

RSEU do të zbatohet në të gjithë Bavarinë gjatë viteve të ardhshme. Ne filluam zbatimin në rrethin/bashkinë tonë në pranverën e vitit 2023. Gjatë fazës kalimtare, fëmijëve parashkollorë që ekzaminohen u bashkohen edhe fëmijët e vitit të parafundit të kopshtit. Fëmijët që nuk mund t'i ekzaminojmë në vitin e tyre të parafundit të kopshtit do të ftohen në ekzaminimin e pranimit në shkollë një vit para se të fillojnë shkollën.

Informacione të mëtejshme mund të gjenden në fletën e bashkëngjitur të informacionit.

**Ju lutemi ejani me fëmijën tuaj për ekzaminimin e pranimit në shkollë:**

më	në	ora	Vendi
----	----	-----	-------

**Ju lutemi sillni me vete dokumentet e mëposhtme për ekzaminimin:**

- **librezën e vaksinimit** (paraqitja e dokumenteve ekzistuese të vaksinimit është **e detyrueshme** sipas Nenit 12 Paragrafi 3 Fjalja 5 e Aktit të Shërbimeve Shëndetësore (GDG)),
- **librezën e verdhë, kartën e pjesëmarrjes nga librezja e verdhë e ekzaminimit ose një certifikatë mjekësore që konfirmon se janë kryer ekzaminimet e zbulimit të hershëm** (sipas Nenit 12 Para. 3 Fjalja 1 GDG),
- **pyetësonin e bashkëngjitur për historikun mjekësor** të fëmijës suaj. Ju kërkohet të përfundoni pyetësonin me kujdes dhe plotësisht në mënyrë që t'ju ofrojmë juve dhe fëmijës tuaj këshillat më të mira të mundshme.

**Nëse disponohen:**

- **Syze, aparat dëgjimi**, kartë identiteti për aftësinë e kufizuar, kartë shëndeti (p.sh., kartë për alergji),
- Vërtetim nga një mjek ORL ose okulist që tregon se fëmija juaj ka kryer një test dëgjimi ose shikimi në 3 muajt e fundit.
- Vërtetim nga logopedi që tregon nëse fëmija juaj aktualisht po trajtohet (jo më i vjetër se 4 javë).

Nëse nuk jeni në gjendje të shoqëroni personalisht fëmijën tuaj në SEU për arsye të justifikuara, personi shoqëruar që ju do të caktoni, do të ketë nevojë për një autorizim nga ju.

**Ju lutemi vini re:**

Shkolla duhet të pajiset me një vërtetim nga organi shëndetësor që konfirmon pjesëmarrjen në ekzaminimin e pranimit në shkollë. Në shkollë nuk kërkohet paraqitja e librezës së verdhë të ekzaminimit! **Pjesëmarrja në ekzaminimin e përmirësuar të pranimit në shkollë është e detyrueshme** sipas nenit 80 fjalja 1 e Ligjit bavarez për Arsimin dhe Mësimdhënien (BayEUG).

Të dhënat nga ekzaminimi dërgohen në formë anonime (pa emër, adresë dhe numër telefoni) në përputhje me Seksionin 11 Paragrafi 1 i Urdhërësës së Kujdesit Shëndetësor të Shkollave (SchulgespflV) tek Zyra Shtetërore për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore dhe vlerësohen statistikisht atje në një mënyrë anonime. Në këtë mënyrë, mund të përftohen njohuri të rëndësishme për gjendjen aktuale shëndetësore të fëmijëve në Bavari. Informacione të mëtejshme mund të gjenden në faqen e internetit në [www.lgl.bayern.de/schulaufnahmesanalyse](http://www.lgl.bayern.de/schulaufnahmesanalyse).

Nëse keni ndonjë pyetje, na telefononi (Tel. 08161-60084-345)

ose na dërgoni një email në [sma@kreis-fs.de](mailto:sma@kreis-fs.de)

Përshëndetje të përzemërta